

10th **Safety Gala Albania**

TIRANA INTERNATIONAL SAFETY CONFERENCE

Mr. Mariel Halilaj

*Director, Directorate of Labor Relations, Safety and Health,
Ministry of Economy, Culture and Innovation*

ERMMC member of
MANAGEMENT FORCE Group
RISK MANAGEMENT & EHSS CONSULTANCY SERVICES

SAFETY SYNERGY
Competence, Growth & Sharing



10th Safety Gala Albania 2025

4 Dhjetor 2025

Prioritetet për vitin 2026

Për vitin 2026 ne vijojmë zbatimin e Planit të Veprimit të “Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2025 - 2030”, konkretisht nëpërmjet realizimit të prioriteteve si më poshtë:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Ndërmnistror për çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (KNSSHP).

- *Objektivi që synohet të arrihet nëpërmjet këtij urdhri është krijimi dhe funksionimi i Këshillit Ndërmnistror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si një organ këshillimor, bashkërendues dhe monitorues i zbatimit të politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë.*

Është hartuar Urdhri për ngritjen e Këshillit Ndërmnistror për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përcaktimin e rregullave procedurale të funksionimit të tij, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të planit të veprimit të Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, miratuar me VKM Nr. 144, datë 06.03.2025.

- *Krijimi i rrjetit të koordinatorëve për zbatimin e dokumentit të Politikave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.*

Aktualisht janë kontaktuar të gjithë pikat e kontaktit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e dokumentit të Politikave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Prioritetet për vitin 2026

2. Përafrimi i legjislacionit me Acquis të BE.

Qëndrimi i Përbashkët i Bashkimit Evropian për Grupkapitullin III “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”, adreson piketat mbyllëse edhe për Kapitullin 19 “Politika sociale dhe punësimi”. Në këtë qëndrim, BE nënvizon se Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin e saj në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë me acquis të BE-së, dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe proceseve të inspektimit.

- ▶ Miratuar nga Kryeministri urdhri për “Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për përafrimin e legjislacionit të brendshëm në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, me acquis e BE”.
- ▶ Përgatitur Plani i Punës për Kapitullin e 19, duke përfshirë të gjitha direktivat e BE-së, që do të përafrohen.

Prioritetet për vitin 2026

3. Forcimi i kapaciteteve inspektuese

- ▶ Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave që rregullon funksionimin e Inspektoratit të Punës.
- ▶ Përbushja e detyrimit institucional për të demonstruar një numër të mjaftueshëm inspektorësh pune me nivele të larta integriteti, me qëllim rritjen e numrit të inspektimeve vjetore dhe zgjerimin e mbulimit territorial.
- ▶ Forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të institucionit për të siguruar ofrim shërbimesh efektive dhe të orientuara drejt qytetarëve, si për individët ashtu edhe për bizneset, duke rritur transparencën, reagimin dhe efikasitetin operativ.
- ▶ Forcimi i kapaciteteve teknike të organit inspektues përmes organizimit të programeve të thelluara të trajnimit në fushat e ligjit të punës dhe Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP).
- ▶ Përmirësimi i infrastrukturës dixhitale duke zhvilluar një ndërfaqe funksionale dhe të integruar midis sistemit MIRA dhe E-Inspection.
- ▶ Përbushja e kërkesës ligjore për të pajisur çdo grup inspektimi me nga një automjet duke ndarë burime, mjete dhe buxhet të mjaftueshëm për të forcuar sistemin e inspektimit të punës.

Prioritetet për vitin 2026

4. Bashkëpunimi në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në kuadër të Procesit të Berlinit, si dhe të Bashkëpunimit Rajonal

Zhvilluar takimi i tretë i përbashkët në datën 24 nëntor 2025, ndërmjet përfaqësuesve të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) dhe Ministrisë Federale Gjermane të Punës dhe Çështjeve Sociale (BMAS), në kuadër të Procesit të Berlinit.

Fokusi i takimit

- ▶ Finalizimin e listës së aktiviteteve të përbashkëta, përmes përzgjedhjes së prioriteteve më të rëndësishme nga lista prej rreth 40 idesh;
- ▶ Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të secilës palë në zbatimin e aktiviteteve;
- ▶ Shqyrtimin e draftit të parë të planit të punës që do të qarkullohet nga BMAS për komente.

Bazuar në listën e propozuar nga BMAS, si dhe në fushat tona të përgjegjësisë, janë identifikuar aktivitetet prioritare për përfshirje në planin rajonal të punës, të cilat do ti përcillen më pas zyrtarisht BMAS-it për përfshirje në përgatitjen e planit të punës rajonal.

Objektivi i përbashkët i vendeve është që plani i punës të finalizohet në fillim të vitit 2026.

Ju faleminderit!